

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® Concrete Primer

PRAJMER POLIUREJE PËR NËNSHTRESAT ME BAZË ÇIMENTOJE PËR HIDROIZOLIM TARRACE/ ÇATIE ME LAM (MEMBRANË E LËNGSHME)

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Concrete Primer është prajmer hibrid poliureje/poliuretani me 2 përbërës për nënshtresa me bazë çimentoje. Performanca e tharjes së shpejtë lejon veshjen e membranës së lëngshme Sika® (LAM) për sistemet e tarracave/ çatave pas 30 minutash.

PËRDORIMET

Prajmer për nënshtresat me bazë çimentoje dhe përdorim në aplikime të jashtme:

- SikaRoof® MTC
- Sistemet për tarracat/ çatitë Sikalastic®
- Sistemet për hidroizolim Sikafloor® balcony

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Rezistencë shumë e mirë e ndërkapjes me nënshtresën
- Redukton mundësinë e degazimit nga nënshtresat e ndjeshme
- Ndihmon në stabilizimin e nënshtresave
- Aplikim i lehtë
- Mund të mbushet me rërë kuarci dhe të përdoret si shtresë fillestare

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Poliure me bazë tretësi	
Ambalazhi	enë 4,5 L	3,5 L Përbërësi A 1,0 L Përbërësi B
	enë 11,5 L	9,0 L Përbërësi A 2,5 L Përbërësi B
Paraqitja / Ngjyra	Lëng / e verdhë e zbehtë	
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit	
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin original, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe në temperatura midis +0 °C dhe +25 °C. Lexoni gjithmonë ambalazhin.	
Dendësia	~1,02 kg/l (në +23 °C)	(EN ISO 2811-1)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	Prajmer Përbërësi A : Përbërësi B = 3,64:1 (për vëllim)									
Konsumimi	~0,13 kg/m ² për veshje Kjo vlerë është teorike dhe nuk përlogarit asnjë material shtesë për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel apo firon, etj.									
Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +30 °C max.									
Pika e vesës	Kujdes kondensimin. Nënshtresa dhe materiali i aplikuar i patharë duhet të jenë të paktën +3 °C mbi pikën e vesës.									
Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +30 °C max.									
Lagështia e përmbajtur e nënshtresës	≤ 4 % pjesë për peshë Mund të përdoren metodat e mëposhtme të testimit: matësi Sika®-Tramex, matja CM ose metoda e tharjes në furrë. Pa rritje të lagështisë sipas ASTM (fletë polietileni).									
Koha e punueshmërisë	Sika® Concrete Primer është krijuar për tharje të shpejtë. Temperaturat e larta të kombinuara me lagështinë e lartë të ajrit do të zgjasin procesin e tharjes. Materiali i pëzier në ambalazh të hapur duhet të aplikohet menjëherë. Në ambalazhin e hapur materiali do të formojë një cipë pas ~ 1 ore.									
Koha e pritjes / mbiveshja	<table><thead><tr><th>Temperatura</th><th>Min.</th><th>Max.</th></tr></thead><tbody><tr><td>10 °C</td><td>60 minuta</td><td>24 orë</td></tr><tr><td>20 °C</td><td>30 minuta</td><td>24 orë</td></tr></tbody></table> <p>Aplikoni një shtresë shtesë nëse kalojnë më shumë se 24 orë përpara lyerjes. Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të ambientit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.</p>	Temperatura	Min.	Max.	10 °C	60 minuta	24 orë	20 °C	30 minuta	24 orë
Temperatura	Min.	Max.								
10 °C	60 minuta	24 orë								
20 °C	30 minuta	24 orë								

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS

Struktura suportuese duhet të ketë rezistencë të mjaftueshme strukturore për aplikimin e të gjitha shtresave të reja dhe ekzistuese të ndërtimit të çatisë/ tarracës. I gjithë sistemi i çatisë/ tarracës duhet të projektohet dhe sigurohet kundër rrëmbimit nga era. Nënshtresat me bazë çimentoje (beton / llaç dysHEMEJE) duhet të kenë strukturë të qëndrueshme dhe me rezistencë të mjaftueshme ndaj kompresionit (min. 25 N/mm²) me rezistencë minimale ndaj tërheqjes 1,5 N/mm².

Nënshtresa duhet të jetë e njëtrajtshme, e qëndrueshme, e niveluar dhe pa dalje të mprehta apo gërvishnje, pa graso, bitum, vaj, pluhur dhe grimca të lira.

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresat me bazë çimentoje duhet të përgatiten mekanikisht me pastrim me rrymë abrazive ose me shkriftor për të hequr koren e çimentos (qumështin) dhe për të arritur një profil sipërfaqeje me teksturë të hapur të përshtatshme për trashësinë e sistemit të produkteve.

Pjesët e dala mund të hiqen me bluarje.

Nënshtresat e dobëta me bazë çimentoje duhet të hiqen dhe defektet e sipërfaqes, si vrimat dhe

hapësirat duhet të ekspozohen plotësisht.

Riparimet mbi nënshtresë, mbushjet e plasaritjeve, vrimave/hapësirave dhe nivelimi i sipërfaqes duhet të kryhet duke përdorur produktet e duhura nga seria e materialeve Sikafloor®, Sikadur® dhe Sikagard®.

Produktet duhet të jenë tharë përpara aplikimit të Sika® Concrete Primer.

I gjithë pluhuri, materiali i lirë dhe i shkrifët duhet të hiqet plotësisht nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të produktit dhe produkteve shoqëruese të sistemit, preferohet pajisje përthithjeje me vakuum.

PËRZIERJA

Veshja fillestare

Përpara përzierjes së të gjithë përbërësve, përzieni më vetë Përbërësin A (rrëshirën) me një mikser elektrik me një helikë ose pajisje tjetër të ngjashme. Shtoni Përbërësin B (forcuesin) tek Përbërësi A dhe përzieni Përbërësit A + B vazhdimisht për 3,0 minuta derisa të përftohet një miks konsistent. Për përzierjen e përbërësve A dhe B mund të përdoret mikser me veprim të detyruar / kovë rrotulluese / elektrik me dy helika ose pajisje tjetër e ngjashme (nuk duhet të përdoren mikserat me rënie të lirë). Shtoni gradualisht kuarcin e thatë në granulometrinë e kërkuar dhe nëse kërkohet edhe Extender T. Përzieni edhe për 2,0 minuta të tjera derisa të përftohet një miks i njëtrajtshëm. Për të siguruar përzierjen e plotë, hidhini materialet brenda një ene tjetër dhe përzieni sërish

për të përftuar një miks konsistent pa kokrriza. Duhet të shmanget përzjerja e tepruar për të pakësuar bllokimin e ajrit. Gjatë fazës përfundimtare të përzjerjes, kruani të paktën një herë anët e enës së përzjerjes me një shpatull për të siguruar përzjerjen e plotë. Përzieri vetëm njësi të plota. Koha e përzjerjes për A + B + rërë kuarci = 5,0 minuta.

Prajmer

Përpara përzjerjes së të gjithë përbërësve, përzieni më vetë Përbërësin A (rrëshirën) plotësisht me një mikser elektrik me një helikë (300–400 rpm) ose pajisje tjetër të ngjashme. Shtoni Përbërësin B (forcuesin) tek Përbërësi A dhe përzieni Përbërësit A + B vazhdimisht për 3,0 minuta derisa të përftohet një miks konsistent. Për të siguruar përzjerjen e plotë, hidhini materialet brenda një ene të pastër dhe përzieni sërish për të paktën 1,0 minutë për të aritur një miks konsistent pa kokrriza. Duhet të shmanget përzjerja e tepruar për të pakësuar bllokimin e ajrit. Gjatë fazës përfundimtare të përzjerjes, kruani të paktën një herë anët e enës së përzjerjes me një shpatull për të siguruar përzjerjen e plotë. Përzieni vetëm njësi të plota. Koha e përzjerjes për A+B = ~4,0 minuta.

APLIKIMI

Ndiqu me rreptësi procedurat e instalimit, ashtu siç përcaktohen në Method Statement, manualin e aplikimit dhe udhëzimet e punimeve, të cilat duhet të adaptohen gjithmonë sipas kushteve aktuale në kantier.

Veshje fillestare

Derdhni materialin e veshjes fillestare mbi nënshtresën e përgatitur dhe aplikoni me mallë. Sigurohuni se një shtresë e vazhdueshme dhe pa pore mbulon nënshtresën. Nëse nevojitet, aplikoni dy veshje. Konfirmo se koha e pritjes/ mbiveshjes është arritur përpara aplikimit të produkteve vijuese.

Prajmer

Derdhni prajmerin e përzjerë mbi nënshtresën e përgatitur dhe aplikoni me furçë, rul ose mallë dhe pastaj kaloni rulin në dy drejtime, vertikalisht dhe horizontalisht. Sigurohuni se një shtresë e vazhdueshme dhe pa pore mbulon nënshtresën. Nëse nevojitet, aplikoni dy veshje prajmeri.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me Sika® Thinner C menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Të mos aplikohet mbi nënshtresa me lagështi në ngritje.
- Të mos përdoret për aplikime në mjedise të brendshme.
- Vëzhgoni vazhdimisht kohën e punueshmërisë së materialit të përzjerë, pasi kjo kohë nuk është e dukshme.
- Shmangni grumbullimin pellg të prajmerit.
- Pas aplikimit, produkti duhet të mbrohet nga lagështia, kondensimi dhe kontakti i drejtpërdrejtë me ujën (shiu) për të paktën 24 orë.
- Të mos aplikohet pranë pjesës hyrëse të ajrit të një

njësie kondicionimi ajri në përdorim.

- Vlerësimi dhe trajtimi i gabuar i plasaritjeve mund të çojë në kohë të reduktuar shërbimi dhe plasaritje reflektive.
- Nëse nevojitet ngrohje, mos përdorni gaz, vaj, parafinë apo ngrohës të tjerë me lëndë djegëse pasi këto prodhojnë sasi të mëdha CO₂ dhe avujsh uji H₂O, të cilët mund të ndikojnë negativisht finiturën. Për ngrohje përdorni vetëm sisteme elektrike ventilimi ajri të ngrohtë.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® Concrete Primer

Tetor 2019, Botimi 03.01

020915951000000010

SikaConcretePrimer-sq-AL-(10-2019)-3-1.pdf

